



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

KËSHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I ARSIMIT, KULTURES, RINISE DHE SPORTEVE

RAPORT VENDIMARRJE

Nr.4, Datë 29/04/2024

Lënda: Vendim për shqyrtimin e projektvendimit nr.4 datë, 13.03.2024 “Plani i Përmirësimit të arsimit parashkollor”

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Berat

Hyrje

Ky Projektvendim paraqitet nga Drejtoria e Arsimit dhe ka si për qëllim përmirësimin e shërbimit në kopshte të Bashkisë Berat.

BAZUESHMERIA DHE VOTIMI	LIGJORE	Ligji 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” datë 17.12.2015 I ndryshuar, Rregullores së Këshillit bashkiak miratuar me Vkb nr,5 datë 30.01.2020 Rregullores së Konsultimit publik miratuar me vkb nr.49 Datë 09.08.2020. Ky projekt vendimi bazohet në nenin 54 të ligjit pika “k”. Votimi që kërkohet është me shumicë thjeshte me 50+1
SITUATA FUNKSIONIT	AKTUALE E	Në vitin 2015, gjatë periudhës së ndryshimeve politike në Shqipëri, u ndërmorën reforma të rëndësishme që preknin strukturën e Bashkive në vend. Këto ndryshime organizative sollën krijimin e 61 Bashkive të reja, duke sjellë me vete sfida të shumta administrative dhe organizative. Këto transformime u realizuan në përpjekje për të decentralizuar më tej pushtetin vendor dhe për të përgjigjur më mirë nevojave për zhvillim dhe mirëqënie sociale dhe ekonomike në nivel lokal. Në lidhje me arsimin parashkollor, Bashkia Berat mori përsipër përgjegjësinë për zbatimin dhe përmirësimin e këtij sektori në territorin e saj. Pas një

	eksperience pune tetë vjeçare në ofrimin e shërbimit të Arsimit Parashkollor, tashmë duke njohur mirë nevojat dhe sfidat Bashkia Berat ka punuar ngushtësisht me donatorë për një plan të qartë afatmesëm për përmirësimin në vijim të shërbimit për të adresuar nevojat dhe sfidat në kopshte
SITUATA FINANCIARE (Impakti financiar, shtesa pakësime në buxhet)	Ky projekt vendim ka impakt financiar në vlerën 1,317,000 lekë per vitin 2024 të cilat do të përballohen nga buxheti i bashkisë dhe janë të parashikuara në Projekt buxhetin afatmesem 2024-2026
DREJTORIA PËRGJEGJËSE	Drejtoria e Arsimit
RAPORTIMI DHE MONITORIMI	Raportimi do te realizohet çdo fund viti per zbatimin e Planit dhe paraqitet çdo fund Janari ne Keshillin Bashkiak
IMPAKTI SOCIAL DHE GRUPET QË PREKEN	Plani prek të gjithë funksionin e Arsimit parashkollor në Bashkinë Berat përveç ushqimit. Organizimin e disa kopshteve ne qender te qytetit dhe kopshte ne fshatrat e Bashkise Berat, infrastruktura, Fuqizimi i Bordeve dhe Këshillave të prindërve etj.
KONSULTIMI PUBLIK	Ky projekt vendim kërkon konsultim publik sipas nenit 17 të Rregullores së Këshillit. Komisioni përgjegjës ka realizuar një konsultim publik me banorët e zonës të cilat janë pjesë e projektvenimit përkatës. Eshte marre vendimi i Kryesise nr. 3, date 13.03.2024 Pe kalimin ne konsultim publik te projektaktit. Eshte hartuar Njoftimi dhe kalendari per degjasat publike. Janë realizuar gjithësej 3 dëgjesa me publikun ku kanë marrë pjesë 120 persona. Jane mbajtur procesverbalet e takimeve dhe kane dale rekomandimet per konsultimin publik te cilat jane permbledhur dhe jane derguar Kryetarit te Bashkise per reflektim, Kryetari i Bashkisë ka dërguar opinionin e tij ku jane diskutuar ne komision.

Komisioni i përhershëm i Arsimit Kulturës, Rinisë dhe Sporteve i mbledhur më datën 29 Prill 2024 pasi shqyrtoj Projektvendimin Për miratimin e Planit të Përmirësimit të Arsimit Parashkollor, racionin dhe dokumentat shoqërues të tij, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë

Pas shqyrtimit të Projektvendimit dhe materialeve shoqëruese

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Ti propozoj Këshillit bashkiak:

- a. Kalimin e projekt aktin në mbledhjen e këshillit për vlerësim të mëtejshëm për vlerësim dhe miratim e projektaktit me ndryshimet si vijon:

Perfshirjen e rekomandimeve të qytetareve në Planin e Permiresimit të cilat janë pjesë e këtij Plani

Mos transferimin e kopshtit Clirim 1 tek Clirim 2 deri në momentin e një projekti konkret rikonstruksioni.

U votua me 4 vota Pro

Asnjë kundër

Kryetari i Komisionit: FLORENCA DEMOLLARI

Nënkryetar i Komisionit: KEJSI HOXHA

Anetar: Donald MOLISHTI

Anetar: Barie KANACI

Anetar: Anduena AZIZOLLI

Berat më: 29.04.2024